

Datë: 19/09/2023

Termet e Referencës

Kompani/Ekspert/e për Zhvillimin e Strategjisë së Organizatës

Hyrje

Organizata Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në Shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë më herët që nga 1999 si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Përgjatë viteve të fundit, OJQ “Syri i Vizionit” ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjerë të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë aktivë në Kosovë dhe rajon si: Komisioni Evropian, Save the Children Kosova/o, Olof Palme International Centre, Solidar Suisse, Volkshilfe Solidaritet, ADA, USAID, KEC, KFOS, DRC, CARE International, OSCE, etj.

Informata të përgjithshme

Syri i Vizionit (SiV) në partneritet me Save the Children Kosova/o (SCiK), tash e disa vite është duke punuar në programe mbi monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, që kanë për qëllim respektimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, në kuadër të të cilave ka zhvilluar projekte për të fuqizuar mekanizmat e parandalimit të dhunës, ndëshkimit trupor dhe raportimit të rasteve të dhunës në shkolla. Në kuadër të programit tematik në fushën e mbrojtjes së fëmijës “**Detyrimi ynë për të Ardhmen - Mbrojtja e Fëmijës dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës**”, po punohet në ngritjen e kapaciteteve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në identifikimin dhe parandalimin e llojeve të dhunës në shkollë ndaj nxënësve, përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale të mësimitdhënësve dhe fuqizimit të mekanizmave ekzistues në shkolla. Pjesë e rëndësishme e këtij programi është zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve humane e logjistike të organizatës.

Objektiva

Syri i Vizionit kërkon një ekspert/e ose kompani për hartimin e Strategjisë dhe planit të veprimit të organizatës për tri vitet e ardhshme (2024-2027), duke u përqendruar në zhvillimin e objektivave strategjike me tregues të matshëm dhe të verifikueshem për organizatën.

Strategjia e re do të përqendrohet rreth katër objektivave kryesore:

- i. Organizimin dhe funksionimi i brendshëm të organizatës;
- ii. Zhvillimin dhe zgjerimin e objektivave strategjike/fushave dhe programeve të SiV;
- iii. Zhvillimin e planit të veprimit; dhe
- iv. Qëndrueshmëria dhe ngritja e fondeve.

Përditësimi strategjisë së SiV do t'i mundësoj menaxhmentit të orientojë angazhimin e tyre në politika të qëndrueshme duke zhvilluar politika dhe mekanizma që ndikojnë në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e organizatës konform programeve dhe objektivave strategjike për tri vitet e ardhshme

Kualifikimi i nevojshëm:

- Diplomë Universitare në Departamentin e zhvillimit të politikave strategjike e humane dhe menaxhment (kualifikimi Master dhe edukimi profesional/joformal në këtë fushë është përparësi);
- Së paku 5 (pesë) vite përvojë në zhvillimin e dokumenteve dhe strategjive në fushat e zhvillimit të politikave, programeve dhe qëndrueshmërisë së institucioneve publike e joqeveritare;
- Njohuri në qeverisjen e brendshme, parimet dhe funksionalizimin e OShC-ve në Kosove;
- Shkathtësi të larta analitike dhe në përpilim të dokumenteve strategjike;
- Shkathtësi të larta në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe dhe angleze.
- Eksperiencë në organizimin e punëtorive me palë të ndryshme interesi, duke e përfshirë edhe fëmijët.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Nga Kompania apo Eksperti/ja i/e angazhuar pritet:

- Përgatitja e planit të punës dhe metodologjisë për përditësimin e strategjisë duke konsultuar të gjitha dokumentet e nevojshme brenda SiV;
- Mbajtja e punëtorisë tri ditore më stafin, menaxhmentin e organizatës si dhe përfaqësues të grupit të fëmijëve Respect our Rights (RoR) për përditësimin e strategjisë së re;
- Përditësimi dhe dorëzimi i strategjisë dhe planit të veprimit (draftit i parë) sipas pikave të dakorduara gjatë punëtorisë jo më vonë se pesë ditë pas përfundimit të punëtorisë;
- Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve pas draftit të parë dhe dorëzimi me kohë i strategjisë dhe planit të veprimit, jo më vonë se tri ditë punë pas pranimit të komenteve dhe sygjërimeve nga SiV dhe SCiK;

- Dorëzimi i raportit narrativ dhe timesheet mbi ditët e angazhuara tek SiV jo më vonë se pesë (5) ditë pune pasi të jenë dorëzuar dokumenti final.

Detyrat Specifike përfshijnë:

- Zhvillimin e objektivave strategjike afatmesme dhe afatgjata në zhvillimin e brendshëm të SiV duke u bazuar në rregulloren për burime njerëzore;
- Zhvillimin dhe zgjerimin e fushave dhe programeve/fokus objektivat e SiV dhe vlerësimin e potencialit të organizatës përmes analizës SËOT;
- Zhvillimin e planit të veprimit;
- Qëndrueshmërinë financiare përmes ngritjes së fondeve dhe programeve;

Angazhimi i Kompanisë/ Ekspertit/es:

Kompania/Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me Syri i Vizionit- nën koordinimin e Menaxherit të Financave dhe Administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument. Angazhimi do të bëhet në baza ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyrat	Kohëzgjatja
Familjarizimi me Strategjinë e SiV dhe dokumentet tjera të brendshme që ndihmojnë në përditësimin e strategjisë së re	2 ditë
Mbajtja e punëtorisë më menaxhmentin, stafin e SiV dhe përfaqësuesit e grupit RoR	3 ditë
Zhvillimi i strategjisë së re të SiV për tri vite	2 ditë
Shkrimi dhe dorëzimi i raportit narrativ dhe timesheets	1 ditë
Gjithsej:	8 ditë

Kushtet e Pagesës:

SiV do të kompensojë kompaninë ose ekspertin individual me një tarifë bruto ditore (për individët do të ndalen dhe paguhen taksat mbi të ardhurat dhe kontributi pensional, bazuar në Ligjin e Kosovës) ose/dhe në një shumë pa TVSH kur kemi të bëjmë me kompani. SiV do ta bëjë pagesën përmes transferit bankar në valutën Euro në llogarinë bankare pas përfundimit dhe miratimit të detyrës (dorëzimit të dokumentit final të strategjisë, raportit narrativ dhe timesheet) dhe dorëzimit të fletëevidencës së plotësuar/fatures.

Dokumentet dhe procedura për aplikim:

- Kopja e Diplomës Universitare për aplikantët individ dhe secilin ekspert të angazhuar nga kompania;
- Certifikata e regjistrimit (për kompaninë);

- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të strategjisë me plan të veprimit dhe mbajtjen e punëtorisë;
- Një letër interesi që përfshinë ekspertizën dhe përvojën në fushën e përkatëse apo të ngjashme;
- Shembuj të dokumenteve strategjike a po dokumenteve të ngjashme të hartuara me herët:
- Përshkrimi i kompanisë duke përfshi shërbimet që ofron dhe kualifikim e stafit (diplomat) si dhe certifikatën e regjistrimit për kompani;
- Letër reference (së paku dy referenca)
- Curriculum Vitae (CV) për individ dhe secilin ekspert të angazhuar nga kompania;
- Propozimi financiar*

**Kërkesa financiare duhet të jetë e detajuar për secilën punë që do të realizohet, këtu duhet të përfshihet, mbajtja e punëtorisë, shkrimi i strategjisë dhe raportit narrativsi dhe një planë tentativë i punës;*

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: info@syriivizionit.org ose naser.lajqi@syriivizionit.org me subjektin Aplikacioni për Ekspert për Hartimin e Strategjisë së Organizatës. Apo edhe përmes postës në adresën e organizatës OJQ: “Syri i Vizionit”, Rr. Isa Demaj, nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: **30 shtator 2023, ora 17:00.**

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!